# DËSHMI ARKIVI

**A-470609**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/eric-wendt-nis-sot-misionin-si-ambasador-i-shba-se-ne-shqiperi-do-ti-dorezo-i588454` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 06:38:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 06:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `589c760b91b2c35d711001192de505c6825dc3f45d371c475b5c014f60f1cc65` |
| TEKSTI | `c4781e500e46fa35f86738a78192b2d30d435d2de837445dbebef78262ecd27f` |
| PAMJA | `86ea4151cc57587eb23318abadf679dc07ffeae57b4fdd35f531e68aafaf9d14` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4ecde5de1e740f00dc41aa79cac85c2f07179fb5dc1d7ab0b7e4f32f29281b42` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4ecde5de1e740f00dc41aa79cac85c2f07179fb5dc1d7ab0b7e4f32f29281b42`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t’i dorëzojë letrat kredenciale Begajt

TemA
26 Shtator 2026, 08:30Bota TEMA



Pas gati 3 vitesh, Ambasada Amerikane në Tiranë do të ketë sërish një ambasador. Eric Wendt nis këtë të shtunë misionin e tij në Shqipëri, duke pasuar Yuri Kim, e cila u largua në qershor të vitit 2023. Wendt do të pritet në orën 11:00 nga Presidenti Bajram Begaj, të cilit do t’i dorëzojë letrat kredenciale. Më pas, do të zhvillojnë një takim kokë më kokë.

Prej largimit të Yuri Kim, në krye të misionit diplomatik amerikan në Tiranë ka qenë Nancy VanHorn, si e ngarkuar me punë. I propozuar nga Presidenti Donald Trump dhe i konfirmuar nga Senati amerikan më 6 gusht, Wendt vjen në Tiranë me një profil kryesisht ushtarak dhe të sigurisë. Ai ka mbi 34 vite shërbim në ushtrinë amerikane, pjesën më të madhe në Forcat Speciale “Green Berets”, ndërsa ka drejtuar edhe Komandën e Operacioneve Speciale të NATO-s.

Prioritetet e mandatit të tij në Shqipëri, Wendt i bëri të qarta që në dëgjesën e 20 majit në Senat. Mes tyre renditi luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të drogës, forcimin e bashkëpunimit në mbrojtje dhe sigurinë kibernetike.

Wendt shprehu mbështetje për SPAK, duke vlerësuar edhe bashkëpunimin e Strukturës së Posaçme me agjencitë amerikane të zbatimit të ligjit. Sipas tij, puna e SPAK mbetet kyçe për sa kohë institucioni ruan pavarësinë dhe qëndron larg ndikimeve politike.

Më 2 tetor, ambasadori i ri do të zhvillojë edhe pritjen zyrtare, ku të ftuar do të jenë përfaqësues të politikës shqiptare nga të gjitha krahët.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Trump refuzon armëpushimin me Iranin, pritet rifillimi i bombardimeve pas zgjedhjeve të nëntorit]

08:20 Bota

[SHBA po planifikon hyrjen ushtarake në Kubë]

07:51 Bota

[“Rifillim i marrëdhënieve mes dy vendeve”/ Gjermania dhe Hungaria rikthejnë bashkëpunimin ushtarak dhe forcojnë lidhjet në NATO]

07:32 Bota

[Irani i propozon SHBA-ve një plan 7-ditor për hapjen e ngushticës së Hormuzit]

22:50 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.